

**AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“PREMIUM PLUS” SH.P.K**

---

Sot, më datë 12.07.2024, unë i nënshkruari:

**Eno Seferi**, datëlindja 14.04.1984 lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal I40414072V;

bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” vendosa të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**PREMIUM PLUS**” sh.p.k, sipas parashikimeve të mëposhtme:

**NENI 1**  
**Emri i shoqërisë**

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është “**PREMIUM PLUS**” sh.p.k.

**NENI 2**  
**Selia e shoqërisë**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Farkë, Rruga “Ullishta”, Pallati Primavera, Kati 1, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë.

**NENI 3**  
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbeshitet atë. Shoqëria ka të drejtë të hapë dhe operojë: Agjenci për prerjen e siguracioneve të makinave dhe produkteve të agjencive të sigurimeve. Agjenci " Imobiliare", nënshkrim kontrata shit-blerje pronash në cilësinë e blerësit apo shitësit, qera, leasing, huapërdorje. emfiteozë, kontrata kalimi të drejtash, kontrata heqje dorë Aluizni, kontrata premtim shitje, etj. të pronave. Të marrë dhe të japë hua si dhe të marrë e të vendosë kolaterale nga: shoqëri, institucione financiare, banka, fondacione, individe brenda dhe jashtë vendit. Investime financiare të lejueshme nga ligji dhe të gjitha llojet e veprimtarive të real-estate Agjensi Imobiliare, ndërmjetësim & marketing në fushën e sigurimeve. Ndërmjetësim financiar, operacione me pasuri të paluajtshme, të luajtshme, tregtare, përfshirë dhënie e garancive, dorëzanie, pengje, hipoteka. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj. Agroturizëm, Administrim pasurish, Dhënie me qera pasuri të paluajtshme, Real Estate. Shoqëria mund të financohet nga shoqëri private vëndase dhe të huaja. Shoqëria mund të blejë, shesë dhe të japë me qera: Makina, motoçikleta, furgona pasagjerësh dhe mallrash, minibus, caravan, rulota, karrela dhe rimorkio të të gjitha llojeve dhe dimensioneve. Të gjitha llojet e mjeteve lundruese, motorra uji. Servisim i të gjitha mjeteve të lartpërmendura. Administrim i të



gjitha llojeve të parkingjeve. Shitblerje e të gjitha llojeve të kornizave artistike dhe kancelarive. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo aktivitet të parashikuar nga Legjislacioni Shqiptar.

#### **NENI 4** **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, me vlerë 100,000 (njëqind mijë) LEKË. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë:

**Ortaku themelues Eno Seferi**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (njëqind mijë) LEKË, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kapitali themeltar do të shlyhet nga ortaku themelues në llogarinë bankare të Shoqërisë, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Një kopje e mandat pagesës bankare të shlyerjes së kapitalit themeltar nga ana e Ortakut të Shoqërisë, depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklaram vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

#### **NENI 5** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 6** **Organet Drejtuese**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj e cila është **Anisa Seferi** atësia Remiz, e datëlindjes 12.10.1986, lindur dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal I66012037C.

#### **NENI 7** **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.



Me nënshkrimin e këtij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet që të hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e të cilit do të depozitohet në QKB.

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që të kryejë procedurat e Rregjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, Administratori mund ta kryejë personalisht, ose me anë personave të caktuar prej tij me Autorizim ose Prokurë të Posaçme.

---

**Ortaku Themelues**

**Eno SEFERI**

